



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN

Nr. 1995/2018

Datë: 11.07.2018

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës nr. 03/L-212, Udhëzimit administrativ nr. 7/2017-Rregullimi i procedurave të konkursit në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ nr. 17/2009 të datës 28.08.2009, Udhëzimit Administrativ nr. 06/2015-normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, shpall:

KONKURS

Për mësimdhënëse mbështetëse

SHFMU "Motrat Qirizi"- në Prizren

- Një mësimdhënëse mbështetëse

(mësimdhënësi krahas punës edukative-mësimore në shkollën "Motrat Qirazi", duhet të mbështes nxënësit me nevoja të veçanta edhe në shkollat: "Fadil Hisari" dhe "Zenun Coçaj" në Gjonaj)

Kualifikimi shkollor:

1. Niveli Master / arsimit gjithëpërfshirës apo arsimit me nevoja të veçanta
2. Fakulteti i edukimit dhe Rehabilitimit-drejtimi përkatës
3. Fakulteti Filozofik – Dega e Pedagogjisë
4. Fakulteti Filozofik – Dega e Pedagogjisë speciale ose
5. Fakulteti i Edukimit, programi i arsimit fillor

Dokumentacioni:

- Kopjen e vërtetuar të diplomës
- Nostrifikimin nëse kandidati e ka të kryer shkollimin jashtë Kosovës.
- Dëshminë mbi përvojën e punës.
- Referencë për rezultatet në punë.
- Trajnimet profesionale.
- Certifikatën e lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (kandidati e sjell pasi të pranohet në marrëdhënie pune).
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se kandidati nuk ka qenë i dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët.

Konkursi mbetet i hapur deri më datë **26.07.2018**

Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Drejtori:
Skender Susuri
